



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dohetuar Prijmehno/Prodato Received/Delivered	30.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHENI	8695/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. nr.992/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani, kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas aktgjykimit A.nr.1001/2021 të datës 09.11.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.85/2021, të parashtruar nga

... në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 992/2022, e datës 11.11.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.03.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.85/2021, me të cilin vendim ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesin

Ankuesi ..., i pakënaqur me vendimin e Këshillit A.nr.85/2021 të datës 29.03.2021, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 23.09.2019, ka parashtrua padi konflikt Administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative.



Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me A.nr.1001/2021 me datë 09.11.2022, ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin aktgjykim ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit \_\_\_\_\_ duke e anuluar vendimin me A.nr.85/2021 të datës 29.03.2021, të Këshillit, duke kthyer çështjen rishqyrtim dhe rivendosje.

*Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesa A.nr.992/2022 të datës 11.11.2022, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Vendimi i Këshillit me A.nr.85/2021 të datës 29.03.2021, Ankesën e datës 18.02.2021 me numër protokollit 702/2021, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës; Njoftimi për anulimin e konkursit i Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës; Njoftimi i datës 01.09.2020, \_\_\_\_\_, dërguar Përshkrimi e detyrave të punës; konkursi i datës 02.07.2020; lista e ngushtë; padi e datës 23.09.2019; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; kërkesa për punësim e \_\_\_\_\_ me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 20.05.2015 e \_\_\_\_\_ Vërtetim i datës 06.07.2020, me numër protokollit 01. Nr. 119-54; kërkesa për punësim e \_\_\_\_\_, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 24.11.2009; Vërtetim i datës 29.04.2009; Akt Emërimi i datës 05.09.2013; Vërtetim i datës 15.05.2019; kërkesa për punësim e \_\_\_\_\_, me shkresat e bashkangjitura; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; dëshmi nga trusti, për periudhën 01.08.2002, deri me datë 30.06.2020 Vërtetim i datës 02.07.2020; Diplomë e datës 09.10.2018; e- maili i datës 11.03.2021; Autorizimi i datës 20.06.2020, i Ministrisë së Administratës Publike; Vendimi i datës 27.07.2020, për Themelimin e Komisionit përzgjedhës; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Përmbledhja përfundimtare e kandidateve; Renditja përfundimtare e kandidateve; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni rekrutues; raporti i datës 14.01.2021, i Komisionit Përzgjedhës i Shërbimit Civil; Procesverbali i mbajtjes së intervistës me gojë; testi me shkrim i \_\_\_\_\_; testi me shkrim i \_\_\_\_\_ Përgjigje në ankesë e datës 11.03.2021, me numër protokollit 1099/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për paanshmërinë e ankesës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komuna e Prishtinës nuk ka ndërmarr veprimet juridike lidhur me kërkesën për përjashtimin e dy prej anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil lidhur me procedurën "Udhëheqës i Sektorit për Pronë", të zhvilluar nga Komuna e Prishtinës; po ashtu ankuesi pretendon që t'í aprovohet ankesa, te shfuqizohet Njoftimi i datës 18.02.2021 i burimeve Njerëzore për anulimin e këtij konkursi dhe të obligohet Komuna e Prishtinës që këtë procedurë të kthejë në pikën e intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin e parë, vlerëson që Komuna e Prishtinës respektivisht Komisioni Përzgjedhës ka qenë i obliguar të shqyrtoj kërkesën e ankuesit për përjashtimin e dy prej anëtarëve të këtij komisioni, mirëpo nga provat e administruara Kolegji vëren se në këtë

procedurë të brendshme të rekrutimit ka pasur shkelje procedurale, me ç'rast e bëjnë të pavlefshme këtë procedurë në cilën do fazë çoftë ajo.

Nga provat e administruara Kolegji i Këshillit, konstaton se shkeljet e evidentuara në këtë procedurë janë se sipas Autorizimit të datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, koeficienti i pagës për këtë pozitë është paraparë të jetë tetë (8), ndërsa me rastin e shpalljes së konkursit ky koeficient është paraparë të jetë tetë pikë pesë (8.5), mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se kemi shkelje të dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, konkretisht nenin 14, 15 dhe 16, sepse në rast kur Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, ka miratuar një pozitë atëherë edhe procedura duhet të shpallet konform këtij autorizimi.

Nga shqyrtimit i përgatitjes së listës së shkurtër për këtë procedurë rekrutimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se konkursi për pozitën përkatëse është mbyllur më datë 07.07.2020 ndërsa sipas Vendimit me Nr. 14-020/04-0127354/20 të datës 27.07.2020 është formuar Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, i cili ka bërë përgatitjen e listës së shkurtër. Ndërsa, nga ky fakt Kolegji vlerëson se lista e shkurtër nuk është përgatitur brenda afateve të përcaktuara me nenin 26 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit"*, si rrjedhojë kemi shkelje të afateve ligjore në këtë rast, pasi që kjo ka rezultuar si vonesë e themelimit të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, kështu që nga ky procesi i vonesave të respektimit të afateve ligjore, edhe fazat e tjera të procedurës janë vonuar sa i përket afateve ligjore konkretisht testi me shkrim dhe me gojë duke u shkelur dispozitat e nenit 32 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Testi i kandidatëve të cilët janë përfshirë në listën e ngushtë bëhet brenda 10 ditë punës pas marrjes së listës së shkurtër përfundimtare"*.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, ka vërejtur se renditja përfundimtare e kandidatëve për këtë procedurë rekrutimit është bërë më datë 04.09.2020, ndërsa raporti filan duke përfshirë edhe rekomandimin për anulimin e kësaj procedure është bërë më datë 14.01.2021, rrjedhimisht në këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 41 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Andaj, bazuar në këtë në këtë procedurë rekrutimit nuk ka pasur kandidatë të suksesshëm për faktin që asnjëri nga kandidatët që i janë nënshtruar fazave të procedurës nuk ka marrë 60% të pikëve siç kërkohet me nenin 40 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje.

Nga të cekurat si më lartë, si dhe nga shkeljet e evidentuara procedurale, këtë procedurë rekrutimi e bëjnë të pavlefshme, rrjedhimisht çdo vendimmarrje tjetër që të obligohet Komuna e Prishtinës që kjo procedurë rekrutimi të kthehet në fazën e intervistës me gojë do të ishte amnisti e shkeljeve procedurale, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka mandat kushtetues dhe ligjor të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, si rezultat i kësaj kur vërehet qartë që ka shkelje procedurale he materiale, atëherë edhe procedura duhet të jetë e pavlefshme, andaj pretendimi i ankuesit që kjo procedurë të kthej në pikën e intervistës me gojë është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A. nr.992/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*